

VILAJETI I KOSOVËS NË KËNDVËSHTRIMIN E GABRIEL LOUIS – YARAYT

GABRIEL LOUIS – YARAY’S PERSPECTIVE ON THE VILAYET OF KOSOVO

Shpend AVDIU¹

¹**Prishtina Institute of Albanology*

Abstract

Gabriel Louis - Yaray's perspective on the Albanian, Serbian, Bulgarian, and Jewish populations, residing in the cities of the Vilayet of Kosovo during the early 20th century will be analyzed in this article. Additionally, his views on industry, agriculture, infrastructure, trade, and the Ottoman administration within this Vilayet will be explored. Moreover, Yaray's perspectives on the socio-political and military developments taking place in the Vilayet of Kosovo will be elaborated.

Keywords: Yaray, travelogue, Vilayet of Kosovo, population, Ottoman Empire.

Përmbledhje

Në këtë trajtesë shkencore do të analizohen këndvështrimet e Gabriel Louis - Yarayt për popullsinë shqiptare, serbe, bullgare dhe hebraike në qytetet e Vilajetit të Kosovës, në fillim të shekullit XX. Përveç këtyre, do të trajtohen dhe pikëshikimet e tij për industrinë, bujqësinë infrastrukturën, tregtinë dhe administratën osmane në këtë vilajet. Po kështu, do të shtjellohen edhe këndvështrimet Yarayt për zhvillimet socio-politike dhe ushtarake në Vilajetin e Kosovës.

Fjalët kyçe: Yaray, udhëpërshkrim, Vilajeti i Kosovës, popullsia, Perandoria Osmane.

Gabriel Louis- Yaray ka botuar dy libra për Shqipërinë gjatë viteve 1913-1914. Këta libra janë shkruar bazuar në udhëtimin e tij që e kishte bërë në Shqipëri në verën e vitit 1909, pas fushatës ushtarake të Xhavit Pashës. Në librin “*Shqipëria e panjohur*”, Yaray shkruan për udhëtimin që e kishte bërë në Shkup, pastaj duke kaluar në Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Lumë, Orosh, Shkodër e deri në Detin Adriatik³⁶².

³⁶² Durim Abdullahu, *Katalog - Udhëpërshkrime shqiptare- Shqipëria dhe shqiptarët në veprat e udhëtarëve dhe misionarëve të huaj*, (Prishtinë: Biblioteka Kombëtare e Kosovës, Pjetër Bogdani”, 2018), 93; Për më shumë shih

<https://doi.org/10.62792/ut.albanologjia.v11.i21-22.p2620>

Por, duhet theksuar se Yaray, Shkupin e kishte vizituar para ardhjes se xhonturqve dhe pas zjarrit të madh që e kishte përfshirë një pjesë të qytetit në vitin 1908. Përfytyrimi i tij i parë për Shkupin ishin xhamitë e shumta me minare, që shkonin drejt qiellit, hijet e të cilave shfaqeshin në ujërat e Vardarit, kurse ndërtesat e tjera në brigjet e Vardarit ishin të ndërtuara pa ndonjë plan rregullues. Një dukuri tjetër që e përmend autori, ishte dhe mungesa koshave të mbeturinave, madje dhe në ndërtesat qeveritare mungonte pastërtia.³⁶³ Ndërsa, funksionimin e administratës osmane e vlerësonte si “regjim të barazisë demokratike”.

Për këtë çështje, ai konstatonte: “*Të gjithë mund të shkojnë, në çdo orë që duan, kur t’i teket tek nënprefekti, prefekti apo të guvernatori*”³⁶⁴. Në këndvështrimin e tij, edhe një lypsar mund të shkonte të valiu dhe kjo shihej si diçka e zakonshme në botëkuptimin e të gjithëve. Në këtë rast, ai bënte një pyetje retorike: “*A mund ta merreni me mend që një zhelan të futet drejtë në zyrën e një guvernatori apo prefekti në Francë?*”³⁶⁵ Pos kësaj, Gabriel Louis Yaray fisnikërinë, zyrtarët shtetërorë e ushtarakë osmanë, i shihte të ngjashëm me fisnikërinë austriake. Sipas tij, te austriakët, gjenerali ishte “shkëlqësi”, kurse oficeri madhor që kishte kryer shërbim për më shumë se 25 vjet është “von”.

Ndërsa, te osmanët, konstatonte se gjenerali ishte pasha dhe kishte të drejtën ta mbante titullin “shkëlqesi” dhe majori titullin, “bej”. Nga ana tjetër, fisnikërinë shqiptare e portretizonte si fisnikëri tjetër fare, të ngjashme me atë të feudalizmit. Ai shkruante se titulli “bej” në hapësirat shqiptare përdorej nga një shtresë e caktuar, zakonisht nga pronarët e tokave³⁶⁶. Përveç këtyre pikëpamjeve, Shkupin ai e paraqiste edhe si një udhëkryq ku takoheshin kombe të ndryshme dhe paraqitej si qytet multietnik. Lidhur me popullsinë e Shkupit, ai vlerësonte se në këtë qytet jetonin rreth 45 mijë banorë. Popullsia e këtij qytetit dominohej nga shqiptarët myslimanë (25 mijë banorë), 10 ose 15 mijë bullgarë, 3000 serbë dhe 2000 hebrenj.

Po ashtu, thekson se në këtë laramani kombesh në Shkup jetonin edhe romë, grekë dhe italianë. Ndërsa, në fshatra, përzierja ishte edhe më e madhe. Ndër të tjera, Yarey theksonte faktin se shqiptarët e Shkupit kishin rrethin e tyre të ndryshëm nga ai i turqve. Kurse, bejlerët shqiptarë në Shkup përveç që ishin pronarë tokash, kishin bujqit dhe qehallarët e tyre, si dhe argatë e shërbyes të shumtë. Gjithashtu, edhe çifligjet e shtëpitë e tyre ishin të dallueshme nga të tjerët në fshatra³⁶⁷.

Pos këtyre që u thanë, Yaray shkruan edhe për ekonominë e Shkupit. Në këtë kuadër, Nexhip bej Dragën e vlerësonte si një ndër personalitetet me ndikimin të madh në gjithë vilajetin. Bazuar në përshkrimin e tij, Draga në pronësinë e tij në rrethin e Mitrovicës kishte një fabrikë të përpunimit të trungjeve, që punonte me makina më avull të importuara nga Evropa. Kurse, banorët e pasur të krishterë të Shkupit ishin kryesisht bullgarë, të cilët merreshin me tregti. Përveç këtyre që u përmenden, në Shkup kishte filluar të zhvillohej edhe industria, që në pikëpamjen e Gabriel Louis Yaray nuk njihej fare në pjesët e tjera të Vilajetit të Kosovës.

Po ashtu, ai shkruan se në këtë kohë, në Shkup punonte një oficinë për riparimin e vagonëve dhe lokomotivave. Sipas tij, në Shkup kishte dhe një fabrikë të vogël të birrës, që ishte në pronësi të serbëve. Pos këtyre fabrikave, ai përmend edhe disa fabrika të litarit, furra të tullave, një fabrikë të vogël patkonjsh, si dhe disa mullinj në rrethinën e qytetit. Gjithashtu, paralajmëronte se do të ngrihej dhe një central elektrik³⁶⁸. Gati të njëjtat të dhëna jepen edhe në gazetën “Dašamiri”, që botohej në Trieste në vitin 1907.

dhe parathënien e Gabriel Hanotiaux, në: Gabriel Louis- Yaray, *Shqipëria e panjohur - Në mbretërinë e re të shqiptarëve*- (Tiranë: Shtëpia botuese “Dituria”, 2006), 9-14, 16, 98.

³⁶³ Yaray, *Shqipëria e panjohur*, 18-21.

³⁶⁴ Yaray, *Shqipëria e panjohur*, 20.

³⁶⁵ Yaray, *Shqipëria e panjohur*, 20.

³⁶⁶ Yaray, *Shqipëria e panjohur*, 20-21.

³⁶⁷ Yaray, *Shqipëria e panjohur*, 22-23; Abdullahu, *Katalog- Udhëpërshkrime shqiptare*, 93.

³⁶⁸ Yaray, *Shqipëria e panjohur*, 23-25; Abdullahu, *Katalog- Udhëpërshkrime shqiptare*, 93

Midis tjerash, shkruhej se në Shkup ekzistonin disa mullinj dhe parashihej që në vitet në vazhdim të zhvilloheshin dy projekte: elektrifikimi i qytetit të Shkupit dhe hapja e një fabrike të birrës³⁶⁹. Për hebrenjtë e këtij qyteti, Yarey shkruan se ata kishin filluar t'i monopolizonin disa degë të ekonomisë, në veçanti atë të shkëmbimit të monedhave.³⁷⁰ Nga ana tjetër, në përshkrimin që i bënë Fushës së Kosovës, midis tjerash shkruante: "... *Këtu ishte qendra historike e Serbisë së Vjetër dhe serbëve, të cilët u shtynë tej viseve të tyre malore qysh kur pushtuesi osman shtiu në dorë fushën. Shqiptarët, të cilët një herë e një kohë ishin shtyrë në malësi, zbritën dalëngadalë drejt Serbisë së Vjetër, Shkupit, Manastirit, madje edhe Selanikut*"³⁷¹.

Po të njëjtin këndvështrim e hasim dhe gjatë përshkrimit që i bën rrethit të Mitrovicës dhe qytetit të Pejës, ku, nder të tjerash, thekson se "shqiptarët kishin zbritur nga malet dhe kishin zënë vendin e serbëve të larguar".³⁷² Këto pikëpamje të Gabriel Louis Yarayt janë pothuajse identike edhe me pikëpamjen Branisllav Nushiqit, i cili ndër të tjera shkruante: "...shqiptarët erdhën nga malet e tyre, të shkreta e shterpa e u vendosën në fshatrat e bukura serbe"³⁷³. Në këtë drejtim, Yaray thekson se serbët i shihnin shqiptarët si përtacë, konstatim të cilin në vazhdim e kundërshton, por këtë e bënte për ta "argumentuar popullimin e kësaj pjese nga shqiptarët". Edhe nga ky libër, duke mos u thelluar më shumë, shihet që Gabriel Louis Yaray ishte i ndikuar nga propaganda serbe si dhe nga kontaktet e tij që kishte gjatë vizitave në konsullatat serbe në Shkup dhe Prishtinë dhe nga shoqëruesit e tij.

Madje, Kosovën shpeshherë e quante si Serbi e Vjetër, por në një rast edhe si qendër historike e serbëve³⁷⁴. Në lidhje me këtë ai shkruante: "*Por, këta shqiptarë nuk e kanë kurrsesi pamjen e një race përtace dhe moskokëçarëse. Përkundrazi. Sidoqoftë ata po vendosen pak nga pak në pllajë. Qeveria e Abdyl Hamitit, natyrisht që përkrah këtë mërgim gjysmë paqësor dhe shqiptarët po qa natyrshëm po shfrytëzojnë këtë qëndrim*"³⁷⁵. Pos tjerash, qytetin e Prishtinës ai e quante fshat të madh të shqiptarëve dhe serbëve të varfër dhe jo miqësor mes vetës, ku në çdo kohë mund të përplaseshin. Prishtinën, gjithashtu e portretizonte si "*fortifikatën e fundit serbe*".

Përkundër përshkrimit të njëanshëm të Yarayt, shqiptarët ishin shumicë në qytetin edhe në kazanë e Prishtinës, sepse siç dëshmohet në Sallnamen e Vilajetit të Kosovës të vitit 1896, Kazaja e Prishtinës kishte 68.661 banorë; prej tyre 52 mijë ishin myslimanë dhe 16.004 jomyslimanë, romë, bullgarë, latinë, hebrenj etj. Në këtë sallname nënvizohet se gjuha e popullsisë ishte shqipja, por flitej dhe turqishtja e bullgarishtja, që nënkuptohet serbishtja.* Kurse, sipas Kristaq Priftit, popullsia e qytetit të Prishtinës në vitin 1908 kishte 18.223 shqiptarë, 1.962 serbë, 1043 romë, 361 hebrenj³⁷⁶.

³⁶⁹ "Škupi, prá, ká filue me perparue eđe n' sanderđi; ktu kena disà mulij driđnaš, sod ášt tuej u vúe per fije ní fabriká biřet e goditun kà mot, por metun kot per mungesà t' disà veglavet e makinavet, madje ášt tuej u perfolá se gýteti kà m'u ndrítue me elektrik e kjo puna kà me šėńue ní perparim t' mađ fort, pse me elektrik vıńa, domosdo, tjera ndertime e trajtime sandeđrijet. Zoti e dašt a e bafta e Škupi kà me kėnà i pari gýtet i Škypnies kí kà mé pasà fat me gzue driten e elektrikut". Agjencia Shtetėrore e Arkivave të Kosovės (ASHAK), F. Fondi i Mikrofilmave. Sig_I/17-1. VILAJETI I KOSOVES. Dašamiri, Trieste, 29- XI, 1907. Shpend Avdiu, *Gazeta "Dašamiri" - "Dašamiri i ri" 1907-1908: Kėndvėshtrime socio-politike dhe kulturore* (Prishtinë: Instituti Albanologjik, 2021), 11, 71.

³⁷⁰ Yaray, *Shqipėria e panjohur*, 25.

³⁷¹ Yaray, *Shqipėria e panjohur*, 30- 31.

³⁷² "Peja ėshtė sot qytet shqiptar par excellence. Por i tillė ėshtė bėrė vetėm nė kohėt tē reja, kur shqiptarėt zbritėn nga malet dhe zunė vendin e serbëve tē larguar." Yaray, *Shqipėria e panjohur*, 40-41, 43.

³⁷³ Branisllav Nushiq, *Kosova-Pėrshkrim i vendit dhe popullsisė*, (Prishtinë: Zgimi, 2015), 97.

³⁷⁴ Yaray, *Shqipėria e panjohur*, 14, 17-18, 26, 31-32.

³⁷⁵ Yaray, *Shqipėria e panjohur*, 31.

³⁷⁶ *Sipas Kemal H. Karpat, popullsia e krishterė e vilajeteve tē Selanikut, tē Manastirit dhe tē Kosovės zyrtarisht pėrbehej nga grekėt dhe bullgarėt dhe jo nga serbet. Pėr mē shumė shih : Kemal H. Karpat, *Popullsia osmane 1830-1914- karakteristikat demografike dhe shoqėrore*, (Tiranė: Alsar, 2016), 56; Kristaq Prifti, *Popullsia e Kosovės (1831-*

Gabriel Louis Yaray, gjatë përshkrimit të Mitrovicës, konstatonte se qytetarët e saj, shqiptarë, turq e serbë në këtë qytet lëviznin pranë njeri- tjetrit. Ndërsa, jashtë qyteti tokat punoheshin nga bujq të kombësive të ndryshme, përderisa pronat e vogla ishin të shqiptarëve. Përveç këtyre, Yaray, nënvizon se ka prona të vjetra të fshatarëve serbë, por shumica ishin bujq çifligarë. Në pjesën e fundit ku e përshkruan Mitrovicën, ai thekson të kundërtën e asaj që thotë me lartë, sepse shkruan se deri në prag të luftërave ballkanike, fshatari serb ishte i ndrydhur nga shqiptarët dhe boshnjakët.

Ndërkaq, fare në fund përmend dhe vrasjen e konsullit rus, i cili sipas tij ishte vrarë “nga një fanatik mysliman vetëm pse një i huaj ishte vendosur në Mitrovicë”³⁷⁷. Në të vërtetë, vrasjen e konsullit e kishte bërë një ushtar osman me orgjinë shqiptare, gjatë një vizite që konsulli ia kishte bërë ushtrisë osmane. Gjithashtu, konsulli një ditë më herët ishte i përfshirë edhe në përleshjen e armatosur të shqiptarëve me ushtrinë osmane, më 30 mars të vitit 1903, ku shqiptarët kundërshtonin reformat në Maqedoni, të propozuara nga Austro-Hungaria dhe Rusia, reforma këto që kërkonin ndryshime në Vilajetin e Selanikut, në Vilajetin e Manastirit dhe në Vilajetin e Kosovës³⁷⁸.

Duhet pohuar faktin se ky libër ishte botuar në vitin 1913, pra në kohën e caktimit të kufijve të Shqipërisë. Më sa kuptohet edhe nga parathënia e Gabriel Hanotaux, libri ishte në shërbim të politikës, i cili nder të tjera thekson: “*Nëse diplomatët dhe publiku i gjerë, do duan të kenë qoftë edhe idenë më të paktë për atë çështje, që gjatë disa vjetëve do të kthehet në një çështje europiane, atëherë duhet të marrin në dorë këtë libër dhe të përsiatin duke lexuar rresht pas rreshti. Sepse ky libër është Bibla dhe Kurani i tyre*”.³⁷⁹

Një dukuri që e përmend autori, madje disa herë, ishte çështja e grave myslimane në Prishtinë, që ishin të mbuluara me ferexhe. Kjo dukuri, sipas tij, në fshatra ishte më pak e shprehur. Për mbulesën e grave myslimane, përveç asaj që kishte hasur vetë në Prishtinë, bazohet edhe në bisedat që kishin pasur bashkëshortja dhe kunata e konsullit serb më fqinjët e tyre shqiptare, të cilat kishin edhe miqësi me disa familje shqiptare³⁸⁰. Një fenomen tjetër që ai e përshkruan në Prishtinë, ishte dhe kontrabanda e duhanit, kurse Rugën e Madhe të Prishtinës e përshkruan para mbrëmjes me njerëz që kalonin me tufa dhish dhe delesh.³⁸¹

Kurse sa i përket Manastirit të Graçanicës atë e cilësonte si një nga mrekullitë e artit të lashtë serb. Ja si e përshkruan ai këtë kishë: “*Ajo është më të vërtetë e veçantë, dhe nga stili i arkitekturës tregon se është nga më të vjetrat. Tradita thotë se vetëm kisha e Deçanit ia kalon për lashtësi. Por, brendia e saj është e mjerueshme dhe të krijon një përshtypje të çuditshme vetmie dhe mungesë banimi*”³⁸². Në këtë vazhdë, Patrikanën e Pejës, apo siç e quante ai “manastiri serb i Shën Savës”, e përshkruan shkurtimisht, kurse arkitekturën e saj e vlerësonte si bizantine me kube të ulëta. Në anën tjetër, Manastirin e Deçanit e paraqiste si më të vjetrin dhe më të pasurin nga të gjitha manastiret, me stil romak më një kube bizantine. Sipas tij, Manastiri i Deçanit ishte i rrethuar me mure të dyfishta dhe me hendek dhe e portretizonte si “fortesë të vërtetë serbe në një vend shqiptar”.

1912), (Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2014), 594-596, 794, 935; Yaray, Shqipëria e panjohur, 32-35; 1896 (Hicri 1314) *Kosova, VILAJETI SALNAMESI (Üsküp, Priştine, Prizren, İpek, Yenipazar, Taşlıca)*, Ed. H. Yıldırım Ağanoğlu (İSTAMBUL: RUMELİ TÜRKLERİ KÜLTÜR VE DAYANIŞMA DERNEĞİ YAYINLARI, No: 3, 2000), 218.

³⁷⁷ Yaray, *Shqipëria e panjohur*, 40-41.

³⁷⁸ Noel Malcolm, *Kosova: një histori e shkurtër*, (Prishtinë: KOHA, 2011),307; Shukri Rahimi, *VILAJETI I KOSOVËS*, (Prishtinë: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, 1969), 106.

³⁷⁹ Për më shumë shih dhe parathënien e Gbriel Hanotaux, në: Yaray, *Shqipëria e panjohur*, 9-11,16; Abdullahu, *Katalog- Udhëpërshkrime shqiptare*, 93

³⁸⁰ Yaray, *Shqipëria e panjohur*, 32-33

³⁸¹ Yaray, *Shqipëria e panjohur*, 32-36

³⁸² Yaray, *Shqipëria e panjohur*, 33-34.

Përveç murgjve, shërbyesve dhe bujqve, kishte edhe një postë ushtarake. Po ashtu, ai potencon se në muret e tij ishin të varura edhe portretet e carëve rusë dhe supozonte se financohej nga Rusia³⁸³. Gjithashtu, Manastirin e Graçanicës dhe manastiret e tjera si kjo, i përshkruan si vende më shumë për t'u mbrojtur se sa si vende për të kryer liturgji fetare. Po ashtu, thekson se kur vendi kalon në pasiguri, kur serbët mbrohen, edhe kur bandat serbe armatosen kundër shqiptarëve nga këto manastire ndihmohen e financohen. Pra, manastiret paraqiten si vende të shenjta të kombësisë serbe, dhe, pamja fetare e tyre shihej nga Yaray si mantel për të mbuluar veprimtarinë e tyre politike³⁸⁴.

Ndërkaq, gjatë vizitës që e kishte bërë në Mitrovicë, ai kishte vizituar edhe Xhavit Pashën në shtabin e tij. Emri i Xhavit Pashës, në këndvështrimin e Yarayt, ishte kthyer në tmerrin e shqiptarëve. Në lidhje me këtë, në përshkrimin e tij, ndër të tjera konstatonte: *“Dhe ashtu siç është, i ri, i gjallë, me pamje luftarake dhe më sy që i xixëllojnë nga gëzimi, ai thotë: “Nisuni shpejt, sepse unë e kam ndërmend që t'u bëjë prapë një vizitë tjetër zotërinjve shqiptarë, patjetër në këtë vjeshtë”*³⁸⁵. Përkundër atyre që u theksuan, Pejën Yaray e shihte si qytet të madh shqiptar, në të cilin banonin fiset më luftarake, ku takoheshin bejlerët dhe udhëheqësit më të pasur të Shqipërisë Veriore.

Njeriu më i pasur i këtij qyteti konsiderohej Jashar Pasha, i cili ishte dhe deputet nga radhët e xhonturqve. Ndërsa, familjen më të njohur e konsideronte atë të Begollëve, e cila posedonte pasuri të mëdha³⁸⁶. Kurse, për Gjakovën theksonte se nga 3.000 shtëpi, vetëm dhjetë ishin serbe, derisa në rrethinë nuk kishte asnjë familje serbe. Ky qytet konsiderohet se ishte i banuar pothuajse vetëm nga shqiptarët. Si në Pejë, ashtu edhe në Gjakovë, dominonin familjet e pasura bejlere. Përveç Riza Beut në Gjakovë, ishte i njohur dhe Bajram Curri, i cili në këtë kohë ishte oficer në Shkup. Pos përshkrimit që iu bën katolikëve të Gjakovës, ai flet edhe për marrëdhëniet e shkëlqyera të myslimanëve dhe katolikëve në Gjakovë në këtë kohë³⁸⁷.

Po ashtu, Gjakova konsiderohej si qendër e rëndësishme tregtare e drithërave dhe tregtia e saj kishte destinacion Selanikun. Por, në këtë kohë nga tregtarët gjakovarë kishte përpjekje që tregtia të drejtohej kah Adriatiku e Shkodra. Gjithashtu, kishte edhe një përpjekje mes tregtarëve të Gjakovës dhe të Shkodrës të krijonin një shoqëri, aksionarët të saj do të ishin tregtarët nga këto qytete.³⁸⁸ Ndërsa, Prizreni, pas Shkupit, konsiderohej se ishte qendra më madhe e banimit në Vilajetin e Kosovës. Përveç xhamive dhe rrugëve të ngushta që e karakterizonin, Yaray e konsideronte tregun e Prizrenit si zemrën e qytetit.

Një vlerësim interesant e jep edhe për stacionin e policisë, që gjendej në qytet dhe që shërbente për të ruajtur qetësinë nga zënkat që vinin për shkak të përplasjeve të njerëzve të fshatit me ata të qytetit. Po ashtu, shkruan për disa rrugë me dyqane të ndryshme, ku zejtarët ushtronin veprimtaritë e tyre. Në këto dyqane punohej argjendi në filigran, pastaj zbukurime me ari etj. Gjithashtu, në rrugët e këtij qyteti kishte edhe dyqane ku regjej lëkura, prodhoheshin thika dhe kama, si dhe dyqane të mëndafshit dhe të pëlurës.³⁸⁹ Me sugjerimin e konsullit rus, Yaray e kishte vizituar edhe sheh Ademin, i cili ishte sa i mistershëm, aq edhe i çuditshëm. Vlerësohej lart kultura e gjerë e këtij shehu. Në këtë libër, Yaray e përshkruan në detaje pamjen dhe veshjen e shehut.

³⁸³ Përkundër asaj që vlerëson Yaray, se Manastiri i Deçanit është më i vjetri, duhet të thuhet se kishat e Patrikanës së Pejës janë të periudhave të ndryshme dhe janë më të hershme se ajo e Deçanit e realizuar në vitin 1327-1335. Për më shumë shih: Fejaz Drançolli, *Trashëgimia monumentale në Kosovë*, (Prishtinë, 2011), 82- 89; Yaray, *Shqipëria e panjohur*, 44-46.

³⁸⁴ Yaray, *Shqipëria e panjohur*, 34.

³⁸⁵ Yaray, *Shqipëria e panjohur*, 39-40.

³⁸⁶ Yaray, *Shqipëria e panjohur*, 43 - 44; Abdullahu, *Katalog- Udhëpërshkrime shqiptare*, 93.

³⁸⁷ Yaray, *Shqipëria e panjohur*, 47; Abdullahu, *Katalog- Udhëpërshkrime shqiptare*, 93.

³⁸⁸ Yaray, *Shqipëria e panjohur*, 47- 48.

³⁸⁹ Yaray, *Shqipëria e panjohur*, 49-50.

Por, ajo që vlen të përmendet ishte biseda që kishte zhvilluar me sheh Ademin, i cili e cilësonte Shqipërinë si Francën para njëmijë vjetëve, dhe në këtë rast ai vlerësonte se kombet e reja ishin si fëmijët, që duhej t'u mësohej gjithçka përmes simboleve dhe tregimeve³⁹⁰. Ndërsa në librin: “*Në mbretërinë e re të shqiptarëve- ç'ka qenë dhe ç'është Shqipëria*”, ai Gostivarin e portretizonte si qytet të banuar thuajse vetëm nga shqiptarët, me rreth njëmijë shtëpi; nëntëdhjetë përqind e popullsisë konsideroheshin shqiptare, kurse pjesën tjetër bullgarë, disa serbë e ndonjë turk. Nga 60 fshatrat e Gostivarit ai thekson se 40 janë shqiptare, të tjerat bullgare e ndonjë serb.

Gratë shqiptare të këtij qyteti i përshkruan të mbuluara më çarçaf të zi e me një napë të madhe deri në gjunjë. Kurse njeriun me ndikimin më të madh në Gostivar e konsideronte Qamil Beun. Një përshkrim detajues e jep dhe për qëndrimin e tij në Tetovë, kurse ajo që spikatë në këtë përshkrim është Teqeja e Bektashinjve dhe funksionimi i saj, e cila përbëhej prej pesë ndërtesave. Kurse bektashizmin e konsideronte si urdhër kombëtar të shqiptarëve. Popullsinë e këtij qyteti në prag të luftërave ballkanike e vlerësonte me rreth 5000 shtëpi, prej tyre 3000 shqiptare, 1200 serbe dhe 800 bullgare, kurse nga 100 fshatra të rrethinës së saj, ai i konsideron 68 shqiptare, tjerat bullgare e pak serbe.³⁹¹

Referencat

- [1]. ASHAK- Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës: Fondet:
- [2]. Fondi i Mikrofilmave. Sig_I/17-1. *VILAJETI I KOSOVES*. Daşamiri, Trieste, 29- XI, 1907.
- [3]. Abdullahu, Durim, *Katalog - Udhëpërshkrime shqiptare- Shqipëria dhe shqiptarët në veprat e udhëtarëve dhe misionarëve të huaj*. Prishtinë: Biblioteka Kombëtare e Kosovës, "Pjetër Bogdani", 2018.
- [4]. Ağanoğlu, H. Yıldırım. Ed., 1896 (Hicri 1314) *Kosova, VILAYETİ SALNAMESİ (Üsküp, Priştine, Prizren, İpek, Yenipazar, Taşlıca)*. İstanbul: RUMELİ TÜRKLERİ KÜLTÜR VE DAYANIŞMA DERNEĞİ YAYINLARI, No: 3, 2000.
- [5]. Avdiu, Shpend, *Gazeta "Daşamiri" - "Daşamiri i ri" 1907-1908: Këndvështrime socio-politike dhe kulturore*. Prishtinë: Instituti Albanologjik, 2021.
- [6]. Drançolli, Fejaz, *Trashëgimia monumentale në Kosovë*. Prishtinë, 2011.
- [7]. Karpaz, Kemal H., *Popullsia osmane 1830-1914- karakteristikat demografike dhe shoqërore*. Tiranë: Alsar, 2016.
- [8]. Louis- Yaray, Gabriel, *Shqipëria e panjohur - Në mbretërinë e re të shqiptarëve*. Tiranë: Shtëpia botuese DITURIA, 2006.
- [9]. Malcolm, Noel - *Kosova: një histori e shkurtër*. Prishtinë: KOHA, 2011.
- [10]. Nushiç, Branislav, *Kosova-Përshkrim i vendit dhe popullsisë*. Prishtinë: Zgjimi, 2015.
- [11]. Prifti, Kristaq, *Popullsia e Kosovës (1831-1912)*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2014.
- [12]. Rahimi, Shukri, *Vilajeti i Kosovës*. Prishtinë: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, 1969.

³⁹⁰ Yaray, *Shqipëria e panjohur*, 52 - 55; Shih dhe parathënien e Hanotaux, 10-11; Abdullahu, *Katalog-Udhëpërshkrime shqiptare*, 93.

³⁹¹ Yaray, *Shqipëria e panjohur*, 6, 97, 191-196; Abdullahu, *Katalog- Udhëpërshkrime shqiptare*, 93